33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA


Numri i kontratës: 632-26-5661-5-2-1/C1232

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës sipas urdhërësës me shkrim nga menaxheri i projektit
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë brenda 24 muajve nga nënshkrimi i kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit

		përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 12 muaj .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Projekti kryesor i rrugës "Qazim Lleshi" Gjakovë					
Paramasa dhe Parallogaria					
AKSI 1: L=0+401,06, km, B=6,5 m, Tr=2x2 m					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Përgaditore				
1	Punët pregaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpunishtës. (Zyrja duhet të ketë kushte të mira për punë, e pajisur me inventar, printer, internet, të ketë tavolinë shtesë - të veçant për projekt menaxherin dhe organin mbikëqyrës)	komplet	1.00	2000.00	2,000.00 €
2	Pastrimi i terrenit, kontrollimi i instalimeve nentokesore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasenë e rrugës (vazo, shporta mbeturinash, reklama etj). Materialet e larguara transportohen në deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km. Para fillimit të punimeve, Investitori duhet të sigurojë të dhënat e instalimeve. Në rast të dëmtimit të instalimeve ekzistuese, duhet të rregullojë vetë punëkryesi.	m'	401.06	2.50	1,002.65 €
3	Shenjëzimi i trasës dhe përcjellja e punimeve me gjeodet	m'	401.06	2.00	802.12 €
4	Gërryerja e asfaltit tek kryqëzimet (te fillimi dhe mbarimi i trasës) dhe e rrugës majtas në mes të stacionazhave 0+047,36-0+075,00 dhe deponimi në vendin e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km.	m ²	479.00	3.00	1,437.00 €
5	Demolimi i kubëzave që gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demoluar transportohet në deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m ²	107.00	1.90	203.30 €
6	Demolimi i gurëve skajorë 18/24 cm së bashku me beton. Materiali i demoluar transportohet në deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	112.50	2.00	225.00 €
7	Demolimi dhe ngritja e pusëtave ekzistuese drejtkëndëshe dhe të tjera të elektrikes të cilat kanë nevojë të pershtaten me niveletën e re, duke përshfshirë rregullimin e konusit. Rregullimi i kokës së pusëtave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	copë	2.00	200.00	400.00 €

L. S. 
 L. O. 
 SH. H. 

8	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese drejtëndeshe dhe tjera të elektrikes te cilat kanë nevojë të pershtaten me niveleten e re, duke përshfshirë rregullimin e konusit dhe zenvendësimin e kapakëve te dëmtuar me peshë deri në 40 t. Rregullimi i kokës së pusetave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demoluar transportohet ne deponin e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	2.00	200.00	400.00 €
9	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese të instalimeve ekzistuese si përgjatë rrugës ashtu edhe në kryqëzimet të cilat trajtohen sipas niveletës së projektuar, duke përshfshir demontimin dhe deponimin e e kapakut, demolim dhe ngritjen e kokës së pusetës dhe rivendosjen e kapakëve te ri deri 42t në nivelin e ri.	copë	2.00	200.00	400.00 €
10	Demolimi I rrethojës ekzistuese dhe rivendosja e tyre (rrethojë, tel me gjemba)	m'	485.36	2.00	970.72 €
11	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast të ndryshimit nga gjendja e projektuar).	m'	401.06	1.00	401.06 €
		Gjithsej me tvsh			8,241.85 €
II	Punët e Gërmimit				
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne trupin e rrugës dhe sanimi i trupit ekzistues ne vendet ku është e nevojshme, bartja e tij ne deponi të përshtatshme në largesi deri ne 15 km e caktuar nga Investitori.	m³	3806.61	3.50	13,323.12 €
2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >40 MPa.	m²	4013.25	1.30	5,217.23 €
		Gjithsej me tvsh			18,540.34 €
III	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushës 0-150mm t=40 cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >60 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te stacionazhat dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	2321.53	12.00	27,858.32 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63mm, t=20 cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>80 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	1333.69	16.00	21,339.04 €
3	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >100 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	465.17	18.00	8,373.02 €

L. S. 
 L. O. 
 SH-H. 

4	Furnizimi, shtrirja e gjeotekstilit 400 gr/m2 Naue ose te ngjajshme (me norma evropiane CE, ETA, EPD, EN ISO 9864, 9863-1, 10319, 12236, 12956, 11058) ne nënbazen e rrugës. Palimi i gjeotekstilit duhet te jete i rregullt 30 cm njeri mbi tjetren. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e gjeotekstilit për kryqëzime dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m ²	3543.63	1.20	4,252.36
5	Furnizimi dhe shtrirja e rërës për mbrojtje të gjeotekstilit nga dëmtimet e mundshme t=5.0 cm. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e rërës për kryqëzimin dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m ³	177.18	17.00	3,012.08 €
6	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthyesit) për punimin e bankinave	m ³	80.21	15.00	1,203.15 €
		Gjithsej me tvsh			66,037.97 €
IV	Punët e Betonit				
1	Gurët skajorë dhe kubëzat				
1	Furnizimi dhe montimi i Gurëve skajorë nga betoni 18/24 cm, të klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaq qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm (±2mm))	m ³	835.00	20.00	16,700.00 €
2	Furnizimi dhe montimi i Gurve Skajor nga betoni 8/20 cm, te klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaq qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjerësia e fugave te jete 12mm (±2mm)), në këtë pozicion përfshihen:	m ³	835.00	18.00	15,030.00 €
3	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e rërës 10-20mm,me trashësi d=5cm	m ³	80.22	25.00	2,005.50 €
4	Furnizimi dhe montimi i kubëzave nga betoni me trashësi t=6cm për trotuare. Kubëzat duhet të jenë të klasës C-30/37.Ngjyra dhe modeli të zgjedhen nga Investitori.	m ²	1,604.24	16.00	25,667.84 €
		Gjithsej me tvsh			59,403.34 €
IV	Punët e Lëshesës Pllakore				
1					
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV për përgatitjen e lëshesës pllakore , bartja e tij ne deponi të përshtatshme në largesi deri ne 15 km e caktuar nga Investitori.	m ³	69.30	3.00	207.90 €
2	Furnizimi, shtrirja e gjeotekstilit 400 gr/m2 Naue ose te ngjajshme (me norma evropiane CE, ETA, EPD, EN ISO 9864, 9863-1, 10319, 12236, 12956, 11058) ne nënbazen e rrugës. Palimi i gjeotekstilit duhet te jete i rregullt 30 cm njeri mbi tjetren. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e gjeotekstilit për kryqëzime dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m ³	42.55	2.00	85.10 €

L. S. Belic
 L. O. L. Olliu
 SH. H. 87

I	Punët Prëgaditore	8,241.85 €
II	Punët e Gërmimit	18,540.34 €
III	Punët e Zhavorit	66,037.97 €
IV	Punët e Betonit	59,403.34 €
V	Punët e Lëshesës Pllakore	7,554.60 €
VI	Punët e Asfaltit	76,203.58 €
VII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	2,000.00 €
Gjithsej me TVSH:		237,981.68 €

Projekti kryesor i rrugës "Qazim Lleshi" - Gjakovë					
SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I. SINJALIZIMI HORIZONTAL					
2	Shënjimi i vendkalimeve për këmbësorë (W=50 cm, H= 400 cm dhe H=300 cm), vijës STOP dhe të ndaljes, me ngjyrë të bardhë, me dy komponente plastik e ftoht, trashësia h>2 mm. Ngjyra duhet te kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit: UNE – EN 1436:2009 + A1:2009.	m ²	172.00	€ 20.00	3,440.00 €
1	Shënjimi i vijës së plotë, gjatësore për ndarje të shiritave të automjeteve, (b=15 cm), me ngjyrë të bardhë me dy komponente, Ngjyra duhet te kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit: UNE – EN 1436:2009 + A1:2009.	m'	150.00	€ 3.00	450.00 €
2	Shënjimi i vijës së ndërprerë 3+3, gjatësore për ndarje të shiritave të automjeteve, (b=15 cm), me ngjyrë të bardhë me dy komponente, Ngjyra duhet te kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit: UNE – EN 1436:2009 + A1:2009. VËREJTEJ: gjatësia është e parqitur vetëm për pjesën e cila do të ngjyroset	m'	130.00	€ 3.00	390.00 €
3	Shënjimi i vijës së ndërprerë 1+1, gjatësore për ndarje të vend-ndalimit për autobus, (b=15 cm), me ngjyrë të verdhë me dy komponente, Ngjyra duhet te kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit: UNE – EN 1436:2009 + A1:2009. VËREJTEJ: gjatësia është e parqitur vetëm për pjesën e cila do të ngjyroset	m'	26.00	€ 3.00	78.00 €
4	Shënjimi i simolit për vend-ndalje të autobusit - BUS, me ngjyrë të verdhë me dy komponente, Ngjyra duhet te kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit: UNE – EN 1436:2009 + A1:2009. VËREJTEJ: në metër katrorë është llogaritur i tërë simboli sipas projektit - pjesës grafike	m ²	5.00	€ 20.00	100.00 €
Gjithsej totali me TVSH - SINJALIZIMI HORIZONTAL					4,458.00 €
II. SINJALIZIMI VERTIKAL					

L-S Gëlle
L-O L. Allu

SH-A. R


1	Furnizimi dhe vendosja e shenjave të trafikut në formë rrethore (Ø 60 cm), me pllakë të aluminit ose metalit të plastifikuar me kënde të kthyer, Tipi i Foljes: EG (Engineer Grade Prismatic Reflective), Klasa 2, sipas standardit EN 12899-1:2007	Cope	10.00	€	50.00	500.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja e shenjave të trafikut në formë trekëndëshi (b= 90 cm), me pllakë të aluminit ose metalit të plastifikuar me kënde të kthyer, Tipi i Foljes: EG (Engineer Grade Prismatic Reflective), Klasa 2, sipas standardit EN 12899-1:2008	Cope	1.00	€	50.00	50.00 €
3	Furnizimi dhe vendosja e shenjave të trafikut në formë katrore (60 x 60 cm), me pllakë të aluminit ose metalit të plastifikuar me kënde të kthyer, Tipi i Foljes: EG (Engineer Grade Prismatic Reflective), Klasa 2, sipas standardit EN 12899-1:2006	Cope	15.00	€	60.00	900.00 €
4	Furnizimi dhe vendosja e shenjave të trafikut në formë drejtkëndore (90 x 60 cm), me pllakë të aluminit ose metalit të plastifikuar me kënde të kthyer, Tipi i Foljes: EG (Engineer Grade Prismatic Reflective), Klasa 2, sipas standardit EN 12899-1:2007	Cope	3.00	€	60.00	180.00 €
5	Furnizimi dhe vendosja e shtyllës nga materiali çelik i galvanizuar Ø 2", me gjatësi 400 cm, për vendosje të 2 simboleve në një shtyllë (vendosja përfshinë hapjen dhe betonimin e themelit me thellësi 60 cm)	Cope	2.00	€	50.00	100.00 €
6	Furnizimi dhe vendosja e shtyllës nga materiali çelik i galvanizuar Ø 2", me gjatësi 320 cm, për vendosje të 1 simboli në një shtyllë (vendosja përfshinë hapjen dhe betonimin e themelit me thellësi 40 cm)	Cope	25.00	€	50.00	1,250.00 €
Gjithsej totali me TVSH - SINJALIZIMI VERTIKAL						2,980.00 €
R E K A P I T U L L I M I - SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL						
I	I. SINJALIZIMI HORIZONTAL					4,458.00 €
II	II. SINJALIZIMI VERTIKAL					2,980.00 €
Gjithsej totali me TVSH						7,438.00 €

Projekti kryesor i rrugës "Qazim Lleshi", Gjakovë					
Paramasa dhe Parallogjaria					
Kanalizimi fekal					
Kolektori 1: L1=0+381.39 km					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët pregaditore				
1	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet. Në teren duhet të bëhet piketimi i të gjitha pusetave sipas projektit dhe përcjellja e punimeve gjatë ekzekutimit. Në llogari është marrë gjatësia e trasesë nëpër të cilën kalojnë gypat.	m'	381.39	2.00	762.78 €

L. S. Belushi
L. O. Lallui

SH-H

2	Pastrimi i terrenit para fillimit të punimeve. Hapja e brezit të punës dhe rregullimi i rrugës për realizimin e punëve. Prerja dhe largimi i shkurreve deri në deponi.	m'	381.39	2.00	762.78 €
3	Kontrolli i instalimeve nëntokësore. Para dhe gjatë gërmimit duhet të identifikohen dhe ruhen të gjitha instalimet ekzistuese, demtimet eventuale të instalimeve nëntokësore do të riparohen nga operatori ekonomik me shpenzime të tij. Para fillimit të punimeve duhet të sigurohen informata nga investitori. Llogaria është dhënë për tërë gjatësinë e trasesë	m'	381.39	2.00	762.78 €
4	Prerja e rrugës së asfaltuar me dy shtresa AB11 t=4cm dhe BA22 t=8cm me gjerësi b=1.00 m për kalimin e gypit të kanalizimit fekal për segmentin mes pusetave PKF14 - PKF16 si dhe hudhja e materialit të deponia legale e caktuar nga Investitori.	m ²	32.00	25.00	800.00 €
5	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar. Në projekt duhet të paraqitet gjendja reale pas ekzekutimit me të gjitha ndryshimet eventuale gjatë ekzekutimit (në rast se projekti ka ndryshime).	m'	381.39	1.00	381.39 €
Gjithsej me tvsh					3,469.73 €
II	Punët tokësore				
1	Gërmimi i kanalit për kolektorit kryesor, kat. III-IV me gjerësi sipas profileve të projektit, dhe transporti i dheut të gërmuar në vendin ku e cakton Investitori, në largësi deri në 5 km. Në largësi të dheut të gërmuar bëhet vetëm pjesa e mbetur që nuk kthehet në kanal. Po ashtu në këtë pozicion është paraparë edhe gërmimi i materialit për zgjerime tek pusetat. Llogaritja është bërë për nivelin prej fundit të kanalit deri te shtresa e zhavorrit 50-150 mm për rastin kur kanalizimi kalon nëpër rrugë, ndërsa për rastin kur kalon jashtë rrugës, është llogaritur deri në shtresën e terrenit.				
1.1	Gërmimi me makinë 90 %	m ³	430.14	6.00	2,580.84 €
1.2	Gërmimi me dorë 10 %	m ³	43.14	10.00	431.40 €
2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm dhe ngjeshja e fundit të kanalit	m ²	310.00	2.00	620.00 €
3	Furnizimi me material dhe sigurimi i kanalit ndaj shembjes së dheut	m ²	1,640.00	2.00	3,280.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi tub dhe ngjeshja (10 cm rerë vendosën nën gyp dhe 15 cm mbi gyp). Në llogari është përfshirë edhe sasia për gypat ndihmës PEHD SN8 250 mm.	m ³	155.50	20.00	3,110.00 €
5	Furnizimi dhe vendosja e shiritit paralajmërues për kanalizim fekal sipas standardeve EN 12613 i cili vendoset 30 cm mbi gyp. Shiriti duhet të ketë rezistencë kimike dhe biologjike ndaj mjedisit	m'	381.39	1.00	381.39 €

L-5 
 L-2 L. Allui'

SH-H 

6	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethanor mbushes 0-150 mm me t = 30 cm për rastin kur kanalizimi kalon nëpër asfalt. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa.	m³	11.59	14.00	162.26 €
7	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorit, fraksion 0-63 mm për mbushjen e kanalit mbi mbushjen gurorë t=20 cm deri në nivelin e mbushjes 0-31mm (Në pjesën e kanalizimit që depërton dhe kalon përgjatë rrugës).	m³	6.79	15.00	101.85 €
8	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorit, fraksion 0-31 mm për mbushjen e kanalit mbi shtresën e zhavorit 0-63mm t=10 cm deri në nivelin e asfaltit apo kubëzave (Në pjesën e kanalizimit që depërton dhe kalon përgjatë rrugës).	m³	3.39	14.00	47.46 €
9	Kthimi i dheut të gërmuar (që është i përshtatshëm për mbushje) në kanal deri në nivelin e terrenit apo të shtresave të rrugës, duke bërë ngjeshjen e tij në shtresa t=30cm.	m³	317.78	2.00	635.56 €
10	Furnizimi, transporti, shtrirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm nën pllakën e poshtme të pusetave, me trashësi t=20 cm. Moduli i ngjeshjes duhet të jetë Mv >50 Mpa	m³	7.85	20.00	157.00 €
				Gjithsej me tvsh	11,507.76 €
III	Punët montuese				
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8				
1.1	SN8 Ø 250 mm	m'	383.00	19.00	7,277.00 €
2	SN8 Ø 250 mm për lidhjet e reja që do të bëhen në të ardhmen nga pusetat ndihmëse në rrjetin e kanalizimit fekal të projektuar. Njëri segment do të jetë nga puseta PKF14 në drejtim të lumit Llukac me gjatësi L = 15 m në të cilën në të ardhmen vazhdohet kanalizimi fekal sipas planit urban	m'	60.00	19.00	1,140.00 €
3	Sigurimi dhe montimi i shkallëve prej shufrave të çelikut Ø 25 mm çdo 30 cm sipas detalit në projekt.	copë	120.00	2.00	240.00 €
				Gjithsej me tvsh	8,657.00 €
IV	Punët e betonit dhe armaturës				
1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit C20/25 për pllakën e poshtme për puseta, d=20 cm (duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335).	m³	7.85	95.00	745.75 €
2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit C20/25 për kinetat e pusetave më përpunim sipas detalit, t=10 cm	m³	2.90	95.00	275.50 €
3	Furnizimi transporti dhe montimi i gypave prej betonit të armuar (për puseta) Ø 1000/1000 mm (elemente të parafabrikuara)	m'	30.00	120.00	3,600.00 €
4	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i konuseve për puseta prej betonit-armuar Ø 600/1000/500 mm (elemente të parafabrikuara)	copë	17.00	120.00	2,040.00 €

L. S. Gjithsej

L. O. Lallumi

SH. H. A.

5	Realizimi i kyqjeve të objekteve në rrjetin e kanalizimit. Gjatësia mesatare e kyqjeve është (10-30) m'. Në këtë pozicion të parashihen të gjitha punët për realizimin e kyqjes.	copë	20.00	100.00	2,000.00
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i pusetave ndihmëse të kanalizimit fekal për lidhjen e kanalizimeve ekzistuese me kanalizimin e projektuar, duke i përfshirë të gjitha elementet përcjellëse të tyre si kapakët për pesha të mesme deri në 25ton të klasës C250 sipas EN 124 bashkë me kinetat, gypat, pllaka nga betoni, shtresën e zhavorrit, shkallët metalike dhe konuset. Thellësia mesatare e këtyre pusetave është (2.2 - 2.5) m.	copë	4.00	1,800.00	7,200.00
7	Furnizimi dhe montimi i kapakëve nga materiali i gizës të klasës C250 sipas EN 124 për pesha të mesme deri në 25 ton. Në çmim të llogaritit edhe rregullimi i kokës së pusetës me beton C-25/30 dhe një rrjetë armaturë Q-335	copë	16.00	180.00	2,880.00 €
8	Furnizimi dhe montimi i kapakëve nga materiali i gizës të klasës D400 sipas EN 124-1 për pesha të rënda deri në 40 ton. Në çmim të llogaritit edhe rregullimi i kokës së pusetës me beton C-25/30 dhe një rrjetë armaturë Q-335	copë	2.00	180.00	360.00 €
		Gjithsej me tvsh			19,101.25 €
V	Punët tjera				
1	Testimi i rrjetit të kanalizimit, dhe dorëzimi i elaboratit nga një kompani e licencuar	m'	381.39	2.00	762.78 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit BA-22 mm me t = 8 cm në rrugë,në pjesen e departimit te kanalizimit fekal për segmentin mes pusetave PKF14 - PKF16 me trashësi t=8 cm.	m²	32.00	20.00	640.00 €
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB-11 mm me t = 4 cm në rrugë,në pjesen e departimit te kanalizimit fekal për segmentin mes pusetave PKF14 - PKF16 me trashësi t=4 cm.	m²	32.00	20.00	640.00 €
4	Pastrimi i terenit pas perfundimit të punimeve, dhe kthimi në gjendjen fillestare.	m'	381.39	2.00	762.78 €
		Gjithsej me tvsh			2,805.56 €
REKAPITULIMI					
I	Punët pregaditore				3,469.73 €
II	Punët tokësore				11,507.76 €
III	Punët montuese				8,657.00 €
IV	Punët e betonit dhe armaturës				19,101.25 €
V	Punët tjera				2,805.56 €
Gjithsej me TVSH:					45,541.30 €

Paramasa dhe Parallogaria					
Kanalizimi atmosferik					
L = 0+358.81 km					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH

L. S. Diliçin
L. O. Lallui

SH. H. B.

I	Punët pregaditore				
1	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet. Në teren duhet të bëhet piketimi i të gjitha pusetave sipas projektit dhe përcjellja e punimeve gjatë ekzekutimit. Në llogari është marrë gjatësia e trasesë nëpër të cilën kalojnë gypat (duke i përfshi edhe rrjetin sekondar).	m'	358.81	3.00	1,076.43 €
2	Kontrolli i instalimeve nëntokësore. Para dhe gjatë gërmimit duhet të identifikohen dhe ruhen të gjitha instalimet ekzistuese, demtimet eventuale të instalimeve nëntokësore do të riparohen nga operatori ekonomik me shpenzime të tij. Para fillimit të punimeve duhet të sigurohen informata nga investitori. Llogaria është dhënë për tërë gjatësinë e trasesë	m'	358.81	1.00	358.81 €
3	Prerja e rrugës së asfaltuar me dy shtresa AB11 t=4cm dhe BA22 t=8cm me gjerësi b=1.00 m për kalimin e gypit të kanalizimit atmosferik për segmentin mes pusetave PKA14 - PKA15 si dhe hudhja e materialit të deponia legale e caktuar nga Investitori.	m²	15.00	4.00	60.00 €
4	Incizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar. Në projekt duhet të paraqitet gjendja reale pas ekzekutimit me të gjitha ndryshimet eventuale gjatë ekzekutimit (në rast se projekti ka ndryshime).	m'	358.81	1.00	358.81 €
			Gjithsej me tvsh		1,854.05 €
II	Punët tokësore				
1	Gërmimi i kanalit për kolektorit kryesor, kat. III-IV me gjerësi sipas profileve të projektit, dhe transporti i dheut të gërmuar në vendin ku e cakton Investitori, në largësi deri në 5 km. Te largimi i dheut të gërmuar behet vetëm pjesa e mbetur që nuk kthehet në kanal. Po ashtu në këtë pozicion është paraparë edhe gërmimi i materialit për zgjerime tek pusetat. Llogaritja është bërë për nivelin prej fundit të kanalit deri te shtresa e zhavorrit 50-150 mm për rastin kur kanalizimi kalon nëpër rrugë, ndërsa për rastin kur kalon jashtë rrugës, është llogaritur deri në shtresën e terrenit.				
1.1	Gërmimi me makinë 90%	m³	332.61	9.00	2,993.49 €
1.2	Gërmimi me dorë 10 %	m³	33.26	10.00	332.60 €
2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m²	330.00	2.00	660.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës Ø-16 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi tub dhe ngjeshja (10 cm rerë vendosën nën gyp dhe 15 cm mbi gyp dhe pjesa tjetër anash gypit). Në llogari është përfshirë edhe sasia e rerës rreth gypave të ujëmbledhësave dhe e gypave sekondarë ndihmës	m³	188.81	23.00	4,342.63 €

L. S. Gjergji

L. D. Lallu

SH.H. H. H.

4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethor mbushës gurorë 0-150 mm t = 30 cm për mbulimin e gypave dhe rreth pusetave. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Llogaria është bërë prej shtresës së rërës deri te niveli i zhavorrit 0-150 mm.	m³	5.50	14.00	77.00 €
5	Furnizimi me material dhe sigurimi i kanalit ndaj shembjes së dheut	m²	620.00	1.00	620.00 €
6	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorit, fraksion 0-63 mm për mbushjen e kanalit mbi mbushjen gurore t=20 cm deri në nivelin e mbushjes 0-31mm (Në pjesën e kanalizimit që depërton dhe kalon përgjatë rrugës).	m³	3.70	15.00	55.50 €
